



BULETIN JAVOR

18-22 MARS 2024

Shprehja

"Siguria kibernetike është një cikël i vazhdueshëm mbrojtjeje, zbulimi, reagimi dhe rikuperimi."

Chris Painter

e javës

Përmbajtja:

- Zhvillohen në Shqipëri Ditët e Ballkanit për Sigurinë Kibernetike
- Fujitsu - Data Breach
- Fortra - Patching Alert



Fujitsu - Data Breach

Kompania japoneze e teknologjisë Fujitsu ka zbuluar sisteme të infektuara me malware dhe paralajmëroi vjedhjen e të dhënave të klientëve nga hakerët.

Malware u gjet në disa kompjuterë biznesi dhe skedarë që përmbajnë informacione personale nga ku të dhënat e klientit mund të fshihen. Fujitsu ka konfirmuar praninë e malware dhe tani po heton se si ai hyri në sistemet e biznesit dhe të dhënat në të cilat kishte akses. Kompania ka informuar Komisionin për Mbrojtjen e Informacionit Personal për incidentin dhe po përgatit njoftime individuale për klientët e prekur.

[Link: Lexo më shumë](#)

PATCHING ALERT



Fortra - Patching Alert

Fortra, kompania amerikane softuerike, ka rregulluar një vulnerabilitet kritik sigurie në zgjidhjen e transferimit të skedarëve FileCatalyst, e cila mund të lejojë sulmuesit e paautorizuar të ekzekutojnë kodin remote.

Vulnerabiliteti, i identifikuar si CVE-2024-25153, lejon që skedarët të ngarkohen jashtë drejtorisë së synuar me një kërkesë POST të krijuar posaçërisht. Fortra ka zgjidhur gjithashtu dy vulnerabilitete të tjera sigurie në FileCatalyst Direct.

[Link: Lexo më shumë](#)



Zhvillohen në Shqipëri Ditët e Ballkanit për Sigurinë Kibernetike

Në kuadër të projektit të DCAF (Geneva Centre for Security Sector Governance) "Qeverisja e Mirë e Sigurisë Kibernetike në Ballkanin Perëndimor mbështetur nga Qeveria Britanike, AKCESK priti sot në Durrës edicionin e dytë të Balkan Cybersecurity Days. Pjesë e këtij organizimi ishte edhe FIRST (Forum of Incident Response and Security Teams), forumi në të cilin AKCESK është anëtarësuar së fundmi.

Ky aktivitet tre ditor u hap me një konferencë ku të ftuar ishin Drejtori i Përgjithshëm i AKCESK, Z. Igli Tafa, drejtori i Sigurisë E-Gov nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit Z. Enis Ylli, si dhe ekspertë të sigurisë kibernetike nga Mbretëria e Bashkuar, Zvicra, Belgjika si nga gjithë Rajoni i Ballkanit. Konferenca vijoi me një sërë sesionesh plenare.